

V E N D I M
Nr.654, datë 30.9.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.472,
DATË 29.9.1993 “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E
KONVIKTORËVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE PËR
NXËNËSIT E STUDENTËT DHE FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E
FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK
DËGJOJNË E NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME
PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE”**

Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Ministrisë së Arsimit të Lartë e Kërkimeve Shkencore dhe Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bursat dhe gjysmëbursat për vitet e para të shkollave 8-vjeçare, të mesme e të larta, miratohen nga këshilli i bashkisë ose komunës, ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi a studenti, kurse për vitet e dyta e lart ndryshohet e miratohen nga vetë shkollat dhe fakultetet, në bazë të kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.472, datë 29.9.1993, dhe kushteve ekonomike të përcaktuara në pasqyrat nr.1 dhe nr.2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

Përfundimisht për vitin arsimor 1996-1997, studentët e viteve të pesta e lart gëzojnë të drejtën e bursës ose gjysmëbursës që kanë pasur sipas listave të vitit arsimor 1995-1996.

2. Bursa, kuota ushqimore dhe pagesa për fjetje në konvikte janë sipas pasqyrave nr.3, nr.4 dhe nr.5 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

3. Për vitin arsimor 1996-1997 Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, për nxënësit e viteve të para, i jepen 750 bursa dhe Ministrisë së Arsimit të Lartë e Kërkimeve Shkencore i jepen 800 bursa.

4. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave është data 30 nëntor 1996.

5. Studentëve të universiteteve dhe shkollave të larta bursa u jepet me lekë në dorë.

6. Efekti ekonomik i rritjes së bursave prej 7 milionë lekësh për periudhën tetor-dhjetor 1996 të përballohet 1.5 milionë lekë nga buxheti i Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, 4.5 milionë lekë nga të ardhurat e pagesës për fjetje të studentëve dhe 1 milion lekë nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë të bëjë kalimin e fondeve në masën prej 4,5 milionë lekë Ministrisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore, Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Financive.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.424, datë 7.8.1995 dhe nr.45, datë 15.1.1996, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KUSHTET EKONOMIKE TE NXENESIT PER DHENIEN E BURSES

Nr. Rend.	Perberja familjare	Te ardhurat per fryme ne familjen e nxenesit		
		Bursa	Gjysem - bursa	me page
1.	Per familjet me 2 persona	deri 1000	mbi 1000 - 1820	mbi 1820
2.	" me 3 persona	" 850	" 850 - 1610	" 1610
3.	" me 4 persona	" 835	" 835 - 1585	" 1585
4.	" me 5 persona	" 780	" 780 - 1520	" 1520
5.	" me 6 persona	" 715	" 715 - 1480	" 1480
6.	" me 7 persona	" 670	" 670 - 1435	" 1435
7.	" mbi 7 persona	" 595	" 595 - 1360	" 1360

Per qytetin:

1. Per familjet me 2 persona
2. " me 3 persona
3. " me 4 persona
4. " me 5 persona
5. " me 6 persona
6. " me 7 persona
7. " mbi 7 persona

Per fshatin: Nxenesit nga fshati perfitojne burse te plote, kur familja fshatare perfiton ndihme ekonomike te plote dhe, 70 per qind te burses se plote kur familja perfiton ndihme ekonomike te pjesshme, te tjeret me page.

KUSHITET EKONOMIKE TE STUDENTIT PER DHENIEN E BURSES

Nr. Rend.	Perberja familjare	Te ardhurat per fryme ne familjen e studentit			mbi	Me
		Bursa	Gjysem	bursa		
1.	Per familjet me 2 persona	deri 1350	mbi 1350	-	2180	2180
2.	" me 3 persona	" 1210	" 1210	-	1970	1970
3.	" me 4 persona	" 1125	" 1125	-	1940	1940
4.	" me 5 persona	" 1035	" 1035	-	1885	1885
5.	" me 6 persona	" 945	" 945	-	1840	1840
6.	" me 7 persona	" 900	" 900	-	1795	1795
7.	" mbi 7 persona	" 870	" 870	-	1715	1715

Per qytetin:

Per fshatin: Studentet nga fshati perfitojne burse te plote, kur familja fshatare perfiton ndihme ekonomike te plote dhe, 70 per qind te burses se plote kur familja fshatare perfiton ndihme ekonomike te pjesshme, te tjeret me pagese.

Pasqyra Nr.3

NIVELI I BURSES DHE KUOTES USHQIMORE PER NXENESIT

Nr. R.	Kategorite e nxenesve sipas shkollave	Bursa	Menyra e mbulimit		Menyra e shpenzimit	
			Nga buxheti	Nga nxenesi	Ushqim	Shpenzime te vogla
1. Shkolla 8 vjecare e te mesme						
-	Bursa	2600	2600	-	2550	50
-	Gjysem burse	1300	1300	1275	1275	25
-	Me pagese	-	-	2550	-	-
2. Shkolla e mjeshterise sportive						
-	Bursa	2900	2900	-	2850	50
-	Gjysem bursa	1450	1450	1450	1425	25
-	Me pagese	-	-	2850	-	-
3. Shkolla e futbollit						
-	Bursa	3650	3650	-	3600	50
-	Gjysem bursa	1825	1825	1825	1800	25
-	Me pagese	-	-	3600	-	-
4. Nxenes te tjere, si jetime, te institucioneve te femijeve qe nuk degjojne e nuk flasin						
-	Bursa	2600	2600	-	2550	50
-	Gjysem bursa	1300	1300	1275	1275	25

NIVELI I BURSES DHE KUOTES USHIQIMORE PER STUDENTIN

Nr.	Kategorite e studenteve sipas shkollave	Bursa	Menyra e mbulimit		Menyra e shpenzimit	
			Nga buxheti	Nga studentit	Ushqim	Fjetje
I.1. Universitetet dhe Akademia e Arteve						
	- Bursa	3450	3450	-	3300	150
	- Gjysem bursa	1725	1725	1725	1650	150
	- Me pagese	-	-	3600	3300	300
2. Studente te I.L.K.F. "Vojo Kushi"						
	- Bursa	3750	3750	-	3600	150
	- Gjysem bursa	1875	1875	1875	1800	150
	- Me pagese	-	-	3900	3600	300
3. Studente te Shkolles se Larte te Infermierise						
	- Bursa	3000	3000	-	2850	150
	- Gjysem Bursa	3000	1500	1500	1425	150
	- Me pagese	-	-	3150	2850	300

II. Pagesa per fjetjen e studenteve jobursiste ne konvikt caktohet nga Ministria e Arsimit te Larte e Kerkeimeve Shkencore, por jo me pak se niveli i percaktuar ne kete pasqyre.

Pasqyra Nr.5

KUOTA DITORE USHQIMORE PER NXENESIT DHE STUDENTET

Nr.	Kategorite e nxenesve dhe studenteve	Kuota ditore ne leke	
		Ishte	Behet
1.	Nxenes te shkollave 8 vjeçare e te mesme	72	85
2.	Studente te shkollave te larta	94	110